

**Letër e hapur
Kryetarit të Komunës së Skenderajt z. Sami Lushtaku**

I nderuari z. Lushtaku,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shprehur që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Huluntuuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në dy debatet e juaja të mbajtura në "Jeta në Kosovë", ju keni premtuar:

- Ndërtimin e pendës në Kushicë, e cila do tua zgjidhë problemin e furnizimit me ujë të pijshëm për 200 mijë banorëve;
- Ndërtimin e Parkut Teknologjik, në të cilin do të punësohen 400-500 të rinj;
- Ndërtimin e kompleksit banesorë, dedikuar kategorive të dala nga lufta, me të cilin do të zgjidhet problemi i strehimit për këtë shtresë të shoqërisë;
- Funkcionalizimin e ujësjellësit në Baks dhe Kopiliq që në fillim të vitit 2010;
- Rregullimin e rrugës në Aqarevë dhe Prellofc;
- Ndërtimin e rrugës që lidhë fshatrat Kllodernicë dhe Izbicë;
- Asfaltimin e poligonit sportiv të shkollës;
- Rregullimin e ujësjellësit dhe rrjetit elektrik;
- Ndërtimin e një ure që lidh lagjet Latifaj, Imeraj dhe Hajdaraj;
- Rregullimin e rrugëve brenda fshatit Cubrel;
- Për fshatin Rakinicë: asfaltimin e rrugës brenda vitit 2010 dhe rregullimin e kanalizimit dhe ujësjellësit;
- Për fshatin Llaush: furnizimin me ujë të pijshëm, rrjet të kanalizimit, dhe punësim;
- Për fshatrat e bashkësisë lokale të Runikut: ndërtimin e objektit shkollorë, rregullimin e kanalizimit, investime në infrastrukturën rrugore;
- Për fshatin Makermal: ndërtimin e shkollës dhe përmirësimin e rrjetit elektrik;
- Për fshatin Rrezallë: rinovim detal të rrugës së dëmtuar që kalon nëpër fshat dhe përmirësimin e rrjetit elektrik;
- Për fshatin Likoc e Plluzinë: rregullimin e sistemit të kanalizimit, ujësjellësit dhe rrjetit elektrik (brenda vitit të parë të mandatit);
- Për banorët e Klinës së Mesme: ndërtimin e rrjetit të kanalizimit dhe përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit;
- Për fshatin Tërnovë: ndërtimin e një rruge të gjatë 1.5 km, rregullimin e një poligoni sportiv në fshat dhe një kontejner ku do të mbahen takimet e fshatit;
- Për banorët e fshatit Radishevë: rrugë të asfaltuar që do ta lidhë rrugën kryesore me objektin shkollorë, ujësjellës dhe rrymë për shkollën dhe rregullimin e poligonit sportiv të shkollës;
- Për fshatin Syrganë: ndërtimin e një rruge të asfaltuar që lidhë fshatin me rrugën rajonale Mitrovicë-Pejë, ndërtimin e rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit;

- Për fshatin Vojnik: ndërtimin e objektit të zyrës së vendit në Turqefc dhe një autoambulancë për punktin shëndetësorë në këtë fshat (brenda vitit 2010);
- Për fshatin Kotorr: sigurimin e transportit të nxënësve deri në shkollën fillore në Klinë të Epërme, rregullimin e çështjes së ujit të pijshëm në shkollën e fshatit dhe ndihmë në sektorin e bujqësisë;
- Ndërtimin e ambulancës në fshatin Plluzinë;
- Ndërtimin e palestrës sportive;
- Hapa konkret për uljen e shkallës së papunësisë dhe zhdukjen e varfërisë;
- Realizimin e projektit të kanalizimit për Prekazin;
- Mbështetje për gratë në çdo iniciativë të tyre;
- Kushte më të favorshme për ushtrim të biznesit;
- Lehtësim të procedurave administrative;
- Përkrahje për shoqëritë amatore kulturo-artistike;
- Renovimin e Shtëpisë së Kulturës dhe menaxhimin adekuat të saj;
- Bursa për nxënës dhe studentë të dalluar;
- Ndërtimin e aneksit të QKMF në Skenderaj;
- Ndërtimin e rrugës unazore në qytet;
- Asfaltimin e rrugëve në qytet, Lubovec, Mikushnicë, Vitak, Rakinicë, Kopiliq i Poshtëm, Acarevë;
- Kanalizim fekal në Runik, Prekaz, Klinë e Poshtme dhe Llaushë ;
- Realizimin e një morie projektesh që përfundimisht do ta nxjerrin Drenicën nga varfëria e thellë, do ta zhvillojnë atë në të gjitha fushat dhe do ta zbusin papunësinë;
- Ndërtimin e rrugës së fshatit Kryshefc në vitin që vjen;
- Ujësjetësin për fshatit Dashefc;
- Ndërtimin e pullazit të shkollës fillore në Izbicë;
- Përmirësimin e mbledhjes së mbeturinave pasi që kompania të kalojë nën menaxhimin e komunës;

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)